

VENDIM
Nr. 21, datë 18.1.2017

PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË DISA
STRUKTURAVE TË POLICISË SË SHETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 68, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë të paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Kategoritë e punonjësve të Policisë së Shtetit, që përfitojnë sigurimin shëndetësor të veçantë, janë si më poshtë:

- a) forcat speciale;
- b) forcat operacionale të ndërhyrjes së shpejtë;
- c) forcat e posaçme operacionale;
- ç) punonjësit e policisë që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive homologe të shteteve të huaja, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

3. Punonjësit e policisë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë nga sigurimi shëndetësor i veçantë, shërbim shëndetësor:

- a) për kontrollin parandalues;
- b) diagnostikues;
- c) kurues.

4. Policia e Shtetit, për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidh kontratë me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

5. Policia e Shtetit, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor të veçantë, kryen procedurat si më poshtë vijon:

- a) brenda muajit korrik të çdo viti, parashikon fondet buxhetore, duke përlogaritur një prim sigurimi jo më shumë se 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo punonjës që do të sigurohet;
- b) brenda muajit dhjetor të çdo viti, harton listën e punonjësve përfitues, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi;
- c) përzgjedh shoqërinë e sigurimit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- ç) njësitë buxhetore i dërgojnë shoqërisë së sigurimit, brenda dy ditëve, çdo ndryshim që ndodh në listën emërore të përfituesve.

6. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim, planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi